VENDIM
Nr. 261, datë 28.12.2020

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, "MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË 'OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR' ALBGAZ SHA" , TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të neneve 6–11, të "rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit nr. 100, datë 5.8.2015, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/3 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 2.7.2020, vendosi:

1. Pika 2, e vendimit nr. 221, datë 20.12.2019, ndryshon si më poshtë: "- Shoqëria "Albgaz" sh.a., të dorëzojë për miratim në ERE, deri në datën 20.12.2020, programin e përputhshmërisë së përshtatur sipas atij, të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, të Bordit të ERE-s, "Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.".

2. Pika 5 dhe 6, bëhen pika 5 me këtë përmbajtje: "- Shoqëria "Albgaz" sh.a., të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, brenda datës 20.12.2020.".

3. Shoqëria "Albgaz" sh.a., të depozitojë në ERE deklaratat e audituesve financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së "Albgaz" sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i gazit natyror' Albgaz sh.a.".

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2017, të ndryshuar, që lidhet me depozitimin në ERE, për miratim, të programit të përputhshmërisë, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka depozituar në ERE këtë program (të përshtatur sipas tij e të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77/2017), pra dokumentacionin e plotë dhe shterues lidhur me këtë pikë. Duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit të certifikimit nr. 179/2017, i ndryshuar.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2020, të ndryshuar, në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46 (10), të ligjit "Për sektorin e gazit natyror" dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Ekonomisë, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim implementimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në sektorin e gazit natyror, me qëllim përmbushjen e kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2017. Ky kusht mbetet ende i paplotësuar për shkaqe se nuk varen nga vullneti i shoqërisë "Albgaz" sh.a.

- Në pritje të vendimmarrjes nga ana e MIE-s, lidhur me ndryshimet ligjore, si dhe duke marrë në konsideratë situatën e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimit të plotësimit të kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2020, deri në datën 20.6.2021.

- Në konsideratë të sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 2.7.2020, dhe duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria ka bërë përpjekjet e saj për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 179/2017, të ndryshuar, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror' Albgaz sh.a.", të ndryshuar.

2. Shoqëria "Albgaz" sh.a. të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i gazit natyror' Albgaz sh.a.", i ndryshuar, brenda datës 20.6.2021.

3. Shoqëria "Albgaz" sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë MIE-s, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti